



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 1331/ 2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Ramadan Demaj kandidat për anëtar kuvendit komunal në Kaçanik nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur për shkak të gabimit teknik gjatë plotësimit të FRK, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuara ankesa e Ramadan Dema nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Kaçanik.

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 24.12.2013 ka pranuar një ankesë, nëpërmjet PTK-së të parashtruar në këtë postë me datën 03.12.2013 nga Ramadan Dema kandidat për anëtar kuvendit komunal në Kaçanik nga rradhët e subjektit politik PDK në të cilën thekson se vendvotimin 0706D/02R në fshatin Dubravë komuna e Kaçanikut sipas parashtruesit të ankesës ka ndodhur një gabim teknik ku subjekti politik PDK ka marrë 122 vota ndërsa parashtruesi i ankesës ka marrë 2 vota dhe se këto vota parashtruesit të ankesës nuk i janë bartur dhe nuk i janë shënuar në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK). Sipas parashtruesit të ankesës këtë e dëshmon me deklaratën e tij të dhënë me shkrim kryesuesi i këshillit të vendvotimit 0706D/02R Nebi Ajdari. Parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi dhe verifikimi i vendvotimit në fjalë dhe se si dëshmi ka bashkangjitur kopjet e FPDHR dhe FRK dhe një deklaratë të komisionarit për të cilin pretendon në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruara nga pala ankuese PZAP-i i konsideron si të pabazuara dhe te pa argumentuara nga shkak se nga veprimet e ndërmara nga PZAP-i në drejtim të vërtetësisë së shkeljes së pretenduar nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1331/2013 më datën 27.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.